



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 13.7, 15.1, 16.2, 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 3.7.2003 dhe të nenit 16, par. 1, shkronja **b** dhe neni 32 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2008, merr

V E N D I M
PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES
“KODRA E TRIMAVE I” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues “Kodra e Trimave I” në Prishtinë.

Neni 2

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi.

Neni 3

Me Planin rregullues nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet hapësira e territorit të qytetit të Prishtinës, e emërtuar si “Kodra e Trimave I”, e cila përkufizohet : nga pika fillestare, Xhamia e Llapit, duke vazhduar përgjatë rrugës “Vëllezërit Fazliu” deri te pikëtakimi me “Unazën e brendshme”, duke vazhduar në anën perëndimore përgjatë trasesë “Unaza e brendshme”, deri në pikëtakimin “Unaza e jashtme”, për të vazhduar në jugperëndim në drejtim të varrezave, sipas pjesës grafike , përbri varrezave të qytetit deri te rruga “Vushtrria”, për të vazhduar përgjatë kësaj deri në pikëprerje me hekurudhën dhe vazhdon në drejtim të veriut deri në pikën fillestare - Xhamia e Llapit, në një sipërfaqe prej ~ 550ha.

Kufijtë e përshkruar të hapësirës nga par. 1 i këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Bartësi i detyrave programore dhe i hartimit të Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të përcaktohet përmes procedurës së tenderimit. Drejtoritë tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, janë të obliguara që të sigurojnë dhe t'i dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për të cilat konsiderohet të jenë të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Mjetet financiare për hartimin e Planit Rregullues sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Plani Rregullues sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

Derisa të bëhet miratimi përfundimtar i planit rregullues për hapësirën e përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi, kërkesat e qytetarëve për zhvillim të punimeve do të zgjidhen përmes dhënies së pëlqimit në lokacion, me mundësinë e inkorporimit të lokacionit përkatës në planin rregullues të këtij kompleksi.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01 Nr. 35-1018, më 16.7.2008

KRYETARI I KOMUNES

Prof.dr. Isa Mustafa